



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E DREJTËSISË - MINISTARSTVO PRAVDE - MINISTRY OF JUSTICE
DEPARTAMENTI PËR PROFESIONE TE LIRA

Komisioni Disiplinor / Disiplinska Komisija / The Disciplinary Committee

Nr. 07/2018

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Bajram Miftari-kryesues, Mahir Tutuli-anëtar dhe Fadil Hoxha-anëtar, në çështjen juridike disiplinore të përmbaruesit privat [REDACTED] i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED] Dega në [REDACTED] i dyshuar për shkelje disiplinore nga: neni 367, paragrafi 1, pika 1.1, 1.2 dhe 1.7 i LPP-së; neni 74, paragrafi 2 dhe 3 i LPP-së; neni 77, paragrafi 1 i LPPP-së; dhe neni 6 paragrafi 2.3 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ mbi Tarifat për Shpërblimet dhe Kompensimet e Shpenzimeve të Përmbaruesit Privat (Udhëzimi Administrativ nr. 06/2014), pas përfundimit të seancës dëgjimore të datës 25.07.2018, ku ishin të pranishëm, përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës - Departamenti për Profesione të Lira, Labinot Gashi, në cilësinë e propozuesit për fillimin e procedurës disiplinore dhe personalisht përmbaruesi privat, në cilësinë e të dyshuarit për shkelje disiplinore, dhe në mungesë të palës ankuese NNP “Shkoza-F07” e cila ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt për seancë, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 25.07.2018, duke vendosur në mënyrë unanime, mori këtë:

V e n d i m

- I. Z. [REDACTED] përmbarues privat i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED], ËSHTË PËRGJEGJËS për shkelje disiplinore nga: neni 367, paragrafi 1, pika 1.1, 1.2 dhe 1.7 i LPP-së; neni 74, paragrafi 2 dhe 3 i LPP-së; neni 77, paragrafi 1 i LPPP-së; dhe neni 6 paragrafi 2.3 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ mbi Tarifat për Shpërblimet dhe Kompensimet e Shpenzimeve të Përmbaruesit Privat (Udhëzimi Administrativ nr. 06/2014), të përshkruar si në propozimin e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, të paraqitur me datën 30.05.2018.
- II. Për kryerjen e veprës disiplinore, përmbaruesit privat z. [REDACTED] i shqiptohet masa disiplinore “gjobë në të holla”, në shumën prej 500 € (pesëqind €), e paraparë me nenin 368, paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

III. Detyrohet përmbaruesi privat, z. [REDAKTUAR] që të bëjë pagesën në emër të gjobës së shqiptuar me këtë vendim, në llogarinë bankare të buxhetit të Republikës së Kosovës, brenda afatit prej një muaji, duke e llogaritur nga dita e dorëzimit të këtij vendimi, përmbaruesit privat.

Ar sy e t i m i

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (në vazhdim të tekstit: Ministria), me datën 30.05.2018, ka paraqitur propozim për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat [REDAKTUAR] i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [REDAKTUAR], për shkak të dyshimit të bazuar se në lëndën përmbarimore të udhëhequr pranë zyrës së tij, P.nr.48/17, ka kryer shkelje disiplinore nga: neni 367, paragrafi 1, pika 1.1, 1.2 dhe 1.7 i LPP-së; neni 74, paragrafi 2 dhe 3 i LPP-së; neni 77, paragrafi 1 i LPPP-së; dhe neni 6 paragrafi 2.3 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ mbi Tarifatat për Shpërblimet dhe Kompensimet e Shpenzimeve të Përmbaruesit Privat (Udhëzimi Administrativ nr. 06/2014).

Në propozim ndër të tjera është theksuar se përmbaruesi privat ka vënë vulën e formës së prerë në urdhrin për caktim përmbarimi, ende pa u plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë, si dhe ka bërë bllokimin e llogarive bankare të debitorit ende pa u plotësuar kushtet ligjore. Gjithashtu, përmbaruesi ka bërë gabime në hartimin e listës së shpenzimeve procedurale, duke e ngarkuar kështu debitorin më tepër se sa do të duhej, siç ka qenë rasti me tarifën për efikasitet të lëndës, me tarifën për përpilimin e pasqyrës së shpenzimeve, etj.

Me datën 25.07.2017, është mbajtur seanca dëgjimore pranë Komisionit, ku kanë qenë të pranishme të dy palët në procedurë. Në seancë nuk është paraqitur pala ankuese, dhe pas konstatimit se e njëjta është ftuar në mënyrë të rregullt, Komisioni ka mbajtur seancën në mungesë të saj.

Në seancën dëgjimore të mbajtur, përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore, dhe i ka propozuar Komisionit që përmbaruesi të shpallet përgjegjës për shkelje disiplinore.

Nga ana tjetër, përmbaruesi privat ka deklaruar gjatë seancës se e pranon përgjegjësinë disiplinore, siç është shtjelluar në propozimin për fillimin e procedurës disiplinore.

Në seancën për këshillim dhe votim, Komisioni në mënyrë unanime ka ardhur në përfundimin se për veprën disiplinore me të cilën është ngarkuar përmbaruesi privat, dhe njëkohësisht të pranuar nga ana e tij, përmbaruesi është përgjegjës dhe se duhet t'i shqiptohet njëra nga masat disiplinore të parapara me ligj. Në përcaktimin e masës disiplinore, Komisioni ka marrë për bazë peshën dhe natyrën e shkeljes disiplinore, pasojat që ka prodhuar tek pala debitore, faktin se përmbaruesi është treguar i sinqertë dhe bashkëpunues me Komisionin duke e pranuar njehërit edhe përgjegjësinë disiplinore, si dhe faktin se ndaj të njëjtit nuk është regjistruar më parë ndonjë shkelje disiplinore, pasi është hera e parë që Komisioni ka shpallur përgjegjës të njëjtin. Duke u

bazuar në këto fakte dhe rrethana Komisioni ka ardhur në përfundimin se masë adekuate disiplinore për rastin konkret është gjoba. Me nenin 368, paragrafi 1, pika 1.3 të LPP-së, “gjoba në të holla” është paraparë si masë disiplinore e cila sipas të njëjtës dispozitë mund të jetë nga shuma prej 500 € deri në shumën prej 3000 €. Komisioni, po ashtu ka ardhur në përfundimin se lartësia e gjobës prej 500 €, është e mjaftueshme për parandalimin e përmbaruesit privat që në të ardhmen të jetë më i kujdeshëm në përmbushjen e mandatit të tij ligjor, si përmbarues privat.

Andaj, duke marrë për bazë natyrën e shkeljes disiplinore, peshën dhe pasojat e saj, si dhe rrethanat lehtësuese të larpërmendura, Komisioni vendosi që përmbaruesit privat t’i shqiptojë masën disiplinore “gjobë në të holla”, në shumën prej 500 €, e paraparë me nenin 368, paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, me bindjen se kjo masë do të arrijë efektin e duhur në veprimtarinë e mëtejshme profesionale të përmbaruesit privat.

Duke u bazuar në të faktet dhe rrethanat e lartcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
Nr. 07/2018, me datën 25.07.2018



Kryesuesi i Komisionit Disiplinor,
Bajram Miftari

UDHËZIMI JURIDIK: Vendimi i Komisionit Disiplinor për Përmbaruesit Privat është përfundimtar. Kundër tij mund të ngritet konflikti administrativ (Neni 374.5 i LPP-së).